



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.07.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për mbrojtjen civile”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Eljo Hysko, Luan Duzha, Lefter Maliqi, Myslym Murrizi, Antoneta Dhima, Edmond Rrushi, Alban Zeneli, Ylli Shehu, Elona Hoxha, Xhemal Qefalia, Luan Harusha, Elena Xhina dhe Arben Elezi.

Mungojnë:

Paulin Sterkaj dhe Anduel Xhindi.

Të ftuar:

Olta Xhaçka - Ministër i Mbrojtjes

Haki Çako - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC)

Ismail Shehu - Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, në Ministrinë e Mbrojtjes

Maksimiljan Dhima - Drejtor i Planifikimit dhe Koordinimit, pranë DPEC

Albana Agastra - Këshilltare për mediat

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare.

Sikundër e përcaktuam edhe gjatë mbledhjes së djeshme, ne sot vijojmë me miratimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për mbrojtjen civile”, ndërkohë që dje kemi përfunduar miratimin në parim të këtij projektligji.

Sigurisht, kemi folur me përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes ose më konkretisht me drejtorin e përgjithshëm të Emergjencave Civile, zotin Haki Çako, zotin Maksimiljan Dhima, drejtor i Planifikimit dhe Koordinimit pranë DPEC-së dhe zotin Ismail Shehu, drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes për disa momente kur ne na duhej të reflektonim gjatë diskutimit nen për nen.

Deri tani kemi marrë edhe vërejtjet që janë bërë nga dy komisionet e tjera, nga Komisioni i Integritetit dhe nga Komisioni i Ligjeve për këtë projektligj, kështu që të shpresojmë që, duke koordinuar të gjitha diskutimet bashkë, të mund të shkojmë drejtë një varianti final sa më të dakordësuar.

Fillojmë me nenin 1 të projektligjit. Relator është zoti Vorpsi. Do t’i ftoj kolegët që në rast se kanë ndonjë objeksion për ndonjërin nga nenet, të marrin fjalën për të bërë sugjerimin ose vërejtjen përkatëse.

Kush është dakord me nenin 1, që bën fjalë për qëllimin dhe objektin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Kush është dakord me nenin 2, i cili bën fjalë për mision që do të ketë Mbrojtja Civile, sipas projektligjit të ri? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 2.

Kush është dakord me nenin 3, i cili përmban të gjitha përkufizimet e këtij projekti?

Ndërkohë më lejon të sjell në vëmendjen tuaj një propozim që ka bërë Komisioni i Integritetit për nenin 3 të projektligjit dhe konkretisht për pikën 16, e cila ka të bëjë me përkufizimin e infrastrukturës kritike me efekt ndërkufitar. Komisioni i Integritetit sugjeron një përmbajtje tjetër të këtij përkufizimi. Kemi parasysh që ligji është bërë duke pasur në vëmendje përafrimin me direktivat europiane, kështu që është shumë e rëndësishme që përafrimi të jetë sa më i plotë.

Unë besoj se Komisioni i Integritetit, i cili ka si detyrë parësore pikërisht kujdesin ndaj përafrimit sa më të plotë, në këtë pikë duhet respektuar. Nuk e di nëse ka ndonjë ndërhyrje nga zoti Çako apo nga kolegët.

Urdhëroni, zoti Çako!

Haki Çako – Është marrë në konsideratë sugjerimi i Komisionit të Integritetit dhe është pasqyruar në projekt.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 3, duke përfshirë edhe sugjerimin e Komisionit të Integritetit? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3.

Neni 4, “Parimi i të drejtës për mbrojtjen në rastet e fatkeqësive”.

Ky nen është deklarativ dhe shpall të drejtën që ka çdo njeri për të qenë i mbrojtur nga fatkeqësitë natyrore dhe për të përfituar kompensimin në rastin konkret.

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Në fakt, nuk e kam konkretisht për nenin 4, por, gjithsesi, mendoj që, nëse nuk gjendet hapësira diku tjetër, mund të jetë një opsion pjesa që ka të bëjë me mbështetjen e veçantë që duhet të kenë gratë dhe fëmijët.

Në të gjitha dokumentet për emergjencat, sidomos ato që mbështetin nga UNDP-ja, theksohet në mënyrë të veçantë që gratë dhe fëmijët duhet të kenë kushte të veçanta dhe t’u ofrohet mbështetje e veçantë, prandaj besoj se është raste që ne ta përmendim. Nëse nuk ka mundësi te neni 4, le të gjejmë një hapësirë diku tjetër, por kjo duhet të përcaktohet dhe nuk duhet të futen në mënyrë të plotë në çdo kategori gratë dhe fëmijët kur themi “çdo person”.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, përfaqësuesi i Ministrisë së Mbrojtjes!

Ismail Shehu – Ligji ka marrë në konsideratë mbrojtjen e të gjithë popullsisë pa përjashtim, sepse ligji është në kontekstin e së drejtës për t’u informuar, ashtu siç në kontekstin e së drejtës për t’u mbrojtur. Nuk mund të bëhen selektime pasi të gjithë qytetarët gëzojnë të drejta të barabarta. Nuk besoj se duhet të specifikohet, megjithëse ka raste kur përcaktohet se kur vihet prioriteti për moshat e mëdha, për gratë dhe fëmijët. Kjo është e pasqyruar te neni 57.

Te neni 57 prioritet kanë shtetasit më të rrezikuar, si fëmijët, të moshuarit, persona me aftësi të kufizuara dhe gratë.

Ermonela Felaj – Besoj që reflektohet shqetësimi juaj, zonja Gjebrea.

Unë jam dakord me vlerësimin tuaj, pavarësisht se ndërhyrja e zonjës Gjebrea është e drejtë, por gjithsesi është reflektuar.

Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 4.

Kalojmë në nenin 5, që bën fjalë për parimin e informimit.

E thamë edhe dje që ligji nuk ka thjesht vetëm një qasje, por ka disa qasje të reja dhe informimi qëndron në bazë të këtyre qasjeve. Pra, është shumë e rëndësishme që për çdo lloj aktiviteti që vjen nga njeriu ose jo, nëse ato janë të rrezikshme për jetën, për shëndetin, për pronën dhe të gjitha me radhë sigurisht duhet të ketë një informim paraprak.

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Duke pasur parasysh edhe mundësitë që kemi ne për të paralajmëruar, ndoshta do të ishte mirë që te pika 2 e nenit 5 të thuhet: “Institucionet qendrore dhe vendore janë të detyruara të njoftojnë komunitetin e një zone të caktuar, e cila ka rrezik të goditet nga fatkeqësitë natyrore apo fatkeqësitë e tjera sipas informacioneve që ata disponojnë. Kjo për arsye se ju mund të mos keni një informacion për një tragjedi dhe nuk keni pse të keni një përgjegjësi të shtuar për diçka që nuk është në dorën tuaj.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Çako!

Haki Çako – Më poshtë kemi nen të veçantë për paralajmërimin e hershëm, i cili specifikon dhe përcakton qartë mënyrën e informimit, marrjen e informacionit, përcjelljes dhe të gjitha modalitetet.

Ermonela Felaj – Dakord.

Kush është dakord me nenin 5? Faleminderit!

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 5.

Neni 6, “Parimi i përgjegjësisë”.

Kush është dakord me nenin 6? Faleminderit!

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 6.

Neni 7, “Parimi i subsidiaritetit”.

Kush është dakord me nenin 7? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Kalojmë te kreu i dytë i ligjit.

Neni 8, “Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë”.

Kam një sugjerim për germën “ç”, që është më tepër i natyrës gjuhësore. Fjala “inkurajuar” të zëvendësohet me fjalën shqipe “nxitur”.

Në përgjithësi do t’i rekomandoja zyrës së redaktimit në Kuvendin e Shqipërisë që projektin ta shikonte edhe një herë nga pikëpamja gjuhësore, sepse vërej se ka pasaktësi në

përdorimin e presjeve, të lidhëzave. Pra, duhet një redaktim që të mos na i përmbysë të gjitha njohuritë gjuhësore që kemi.

A ka ndonjë sugjerim tjetër nga kolegët për këtë nen?

Kush është dakord me nenin 8? Faleminderit!

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 8.

Neni 9, “Vlerësimi i riskut”.

Kolegë, ju kujtoj që në pikën 2 të këtij neni vendoset afati 3-vjeçar për bërjen e vlerësimit të riskut në nivel qendror, në nivel qarku dhe në nivel vendor. Bëhet jo më pak se një herë në 3 vjet dhe vlerësimi i riskut në nivel qendror, thotë pika 3, miratohet me vendim të KM-së me propozim të ministrit.

Kur të shkojmë te nenet e fundit të projektligjit, do të shohim se edhe afati i propozuar për nxjerrjen e këtij akti nënligjor, miratimin e vlerësimit të riskut, është një vit.

A jeni dakord që miratimi i vlerësimit të riskut të jetë një vit, sepse dje bëmë një ndërhyrje dhe thamë që afatet në përgjithësi të përpilimit të akteve nënligjore janë shumë të gjata, kështu që të tregohemi pak më konciz dhe rast pas rasti, aty ku kemi mundësi këto afati t’i zvogëlojmë.

A jemi dakord me këtë? Do të doja një koment nga zoti Çako.

Haki Çako – Ne diskutuam lidhur me afatet e përpilimit. Nëse diskutojmë për afatet e përpilimit jemi përballë një ligji që ka volum dhe aktet normative nënligjore që dalin në zbatim të ligjit do të jenë të konsiderueshme.

Në këto kushte, nisur edhe nga nevoja për të miratuar Strategjinë Kombëtare të Mbrotjtjes Civile, që është një dokument shumë i rëndësishëm që përcaktohet në ligj, të gjitha aktet e tjera janë pak a shumë të kushtëzuara në kohë.

Gjithsesi, nëse ju e konsideroni që mund ta reduktojmë kohën, ne mund ta shohim.

Ermonela Felaj – Unë kam parasysh që ne kemi thënë se institucionet vendore deri në nivel qarku duhet ta bëjnë vlerësimin e riskut një herë në 3 vjet, ndërkohë që KM-së i lihet një afat 2-vjeçar për të bërë vlerësimin e parë të riskut, se për këtë akt po diskutojmë. Nuk më duket optimale që KM-ja të marrë 2 vjet për të bërë një miratim formal të vlerësimit të riskut, prandaj po e diskutoj këtu.

Urdhëroni, zoti Shehu!

Ismail Shehu – Në fakt, edhe prefekturat, edhe bashkitë e kanë 3 vjet afatin për miratimin e dokumenteve të vlerësimit të riskut dhe strategjive vendore apo rajonale të vlerësimit të riskut për arsye se këto janë strategji dhe dokumente, të cilat do të kërkojnë që

njerëzit të dalin në terren dhe të bëjnë vlerësime reale të matshme se nga vijnë risqet që çojnë në fatkeqësi natyrore apo fatkeqësi të tjera.

Ermonela Felaj – Zoti Shehu, po ju kujtoj diçka. Ju keni vënë afatin 15 ditë për hyrjen në fuqi të ligjit, ndërkohë ligji për efektet financiare fillon më 1 janar 2020, që do të thotë se nga korriku deri në fund të dhjetorit këto muaj do të ezaurohen, shtoj edhe 3 vjet, shtoj edhe 15 ditë, mbaron edhe afati i të zgjedhurve, se 4 vjet janë. Kështu do të fillojë e njëjta histori, do të fillojnë këshillat e reja të qarqeve, të cilat nuk kanë fare rekorde të punës (po e marrim rastin ekstrem) dhe do ta pasojmë nga njëri te tjetri, prandaj e kam merak unë.

Po vlerësoj se ne mund ta kalojmë nenin këtu, por kur të shkojmë tek afatet t'i marrim dhe t'i rishikojmë një nga një. Unë e kuptoj që për Strategjinë Kombëtare duhet kohë më shumë, por për aktet e prejardhura nga Strategjia Kombëtare ose jo, që miratohen në vend, që s'ka nevojë të kemi parasysh këtë linjë, por kanë ligjin, ne mund t'i ulim.

Ismail Shehu – Në mund t'i ulim me dyvjeçarin dhe është optimale, besoj.

Ermonela Felaj - Kush është dakord me nenin 9, sipas propozimit të ardhur nga ministria? Faleminderit!

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 9.

Neni 10, “Strategjia Kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë”.

A ka ndërhyrje për këtë nen?

Strategjia Kombëtare rishikohet një herë në 5 vjet.

Unë do të isha për një shtesë te pika 2, ku të thuhet “Strategjia Kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë rishikohet jo më pak se një herë në çdo 5 vjet nga KM-ja me propozim të ministrit”.

A jemi dakord me këtë propozim?

Kush është dakord me nenin 10 me referencën e bërë për pikën 2? Faleminderit!

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 10.

Neni 11. Për nenin 11 ka një ndërhyrje nga Komisioni i Ligjeve, ku është propozuar që strategjia vendore të miratohet minimalisht cdo 4 vjet. Kam përshtypjen që gjithë diskutimi është nisur nga fakti që mandati i njësive vendore është 4-vjeçar.

Po e shtroj për diskutim këtë se meraku është te boshllëku që mund të krijohet nga momenti kur mbaron një mandat te tjetri.

Urdhëroni, zoti Çako!

Haki Çako – Është marrë në konsideratë fakti që jo domosdoshmërisht mund të përkojë në kohë miratimi i strategjisë me kohën kur konstituohen këshillat apo bëhen zgjedhjet. Ky është një dokument i rëndësishëm që vijon në bazë për zbatim të SK-së të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë, kështu që nuk besoj se interpretimi i saj mund të ketë karakter politik.

Ermonela Felaj – A ka komente të tjera?

Urdhëroni, zoti Vorpsi!

Sadi Vorpsi – Unë e ndoqa me vëmendje zotin Çako, si dhe vlerësoj edhe qëndrimin e Komisionit të Ligjeve, por duke vlerësuar faktin se ky projektligj nga shtatori do të jetë funksional, do të kemi probleme në pjesën e konstituimit të këshillave bashkiake, ndaj unë mendoj se afati 5-vjeçar është më se i përshtatshëm.

Ermonela Felaj – Dakord.

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Nëse do të shikojmë nenin 11 shohim se aty thuhet: “Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë duhet të jetë e miratuar nga këshilli bashkiak dhe e harmonizuar me SK-në për zvogëlimin e riskut”. Pra, strategjitë vendore nuk bëhen dot pa u vendosur SK-ja, e cila është njëherë në 5 vjet, kështu që detyrimisht ato duhet të jetën të dyja në një afat kohor.

Ermonela Felaj – Besoj se të gjitha komentet tona shkojnë drejt mbështetjes së propozimit ashtu siç ka ardhur nga ministria, kështu që do ju ftoja ta miratonim këtë nen.

Kush është dakord me nenin 11, siç është propozuar? Faleminderit!

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 11.

Neni 12.

Kush është dakord me nenin 12? Faleminderit!

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 12.

Neni 13.

Këtu do të tërheq vëmendjen për pikën 7, sepse edhe kjo hynë ndër ato pikat, të cilat do t'i diskutojmë në fund për çështjen e afatit.

Ideja është që kur një subjekt privat zhvillon një investim dhe për këtë i duhet një leje zhvillimore duhet të marrë nga Këshilli Kombëtar i Territorit një vërtetim për riskun. Afati i përgatitjes së këtij vërtetimi është lënë 2 vjet, që duket se është afat goxha i gjatë, ndërkohë që ne kemi investime që vijnë. Mendoj se KKT-ja ka fituar aq eksperiencë sa për të përcaktuar modalitetet e sakta që i referohen kësaj problematike.

I ftoj kolegët, që kur të diskutojmë nenin 72, ta kemi parasysh këtë pikë, nëse afati 2-vjeçar për lëshimin e këtyre vërtetimeve është afati i duhur apo jo.

Urdhëroni, zoti Shehu!

Ismail Shehu – Nga ana e teknikës janë unifikuar të gjitha VKM-të që do të dalin, të cilat janë 17 në total dhe janë futur në një nen. Duke pasur parasysh volumin dhe kompleksitetin janë lënë total 2 vjet, megjithatë është shumë i drejtë sugjerimi juaj, se të presësh 2 vjet për përcaktuar procedurën dhe afatin e një dokumenti është paksa i zgjatur.

Në rast se ka një sugjerim konkret ne mund ta nxjerrim te kalimtarët si dispozitë më vete, që ky vendim të dalë brenda një afati 3-mujor apo 6 –mujor, duke pasur parasysh që ligji i shtrin efekt nga data 1.1.2020, besoj se një periudhë 6-mujore është më se normale për një dispozitë konkrete.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

A ka komente të tjera?

Kush është dakord me nenin 13? Faleminderit!

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 13.

Më lejoni ta them për arsye të regjistrimit të mbledhjes, se Komisioni i Ligjeve për këtë pikë ka sugjeruar që ankimi ndaj vendimit të KKT-së ose kryetarit të bashkisë në lidhje me vërtetimin e riskut të bëhet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të vërtetimit. Është sugjeruar që të bëhet në Gjykatën Administrative.

A jemi dakord me këtë? Dakord.

Pra neni 13, me gjithë sugjerimin e bërë për pikën 6, miratohet.

Neni 14 bën fjalë për planet për emergjencat civile.

Është një nen me 8 pika. A ka ndërhyrje për këtë nen?

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Te pika 8 thuhet se do të ketë një plan për urgjencat civile nga institucionet shtetërore, private, sektori i shëndetësisë etj., etj. dhe ky plan duhet të jetë i harmonizuar me planin vendor për emergjencat civile.

Nuk përmenden afatet...

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Për pikën 8 që ju flisni nuk është parashikuar ndonjë afat, as te aktet nënligjore. Ka vetëm për pikën 4.

Shkoni nenin 72 në lidhje me nenin 14!

Urdhëroni, zoti Shehu!

Ismail Shehu – Plani i emergjencave ka pasur në çdo rast nivel qendror dhe vendor. Këtë radhë po shkojmë edhe në rrugë horizontale, pra përveçse në nivel qendror dhe vendor apo edhe rajonal në qarqe, planin për emergjencat do ta miratojnë edhe institucionet përgjegjëse për arsimin, mirëqenien sociale, kulturën, mjedisin, turizmin etj. Duke qenë se është risi absolute, meqenëse s’ka pasur Shqipëria këtë lloj eksperience, e kemi lënë enkas të hapur dhe pa afat në mënyrë që të marrim kohën e duhur, se deri tani jemi jashtë çdo lloj parashikimi me këtë dispozitë.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Unë mendoj se ju keni bërë shumë ushtrime dhe keni treguar që jeni në gjendje që të mobilizoni edhe institucionet e tjera dhe t’i vini përpara përgjegjësive. Duke qenë se keni marrë përsipër gjithë këtë ndërmarrje të madhe dhe po bëni revolucion në kuptimin e emergjencave civile, mendoj se nuk ka asnjë gjë të ekzagjeruar t’u vini një afat, se ju lehtëson juve, në fund të fundit.

Ermonela Felaj – Atëherë, a mundemi të bëjmë një zgjidhje të mesme?

Nuk është se në këtë nen nuk kemi një afat sipas propozimit në tërësi të ligjit. Kemi një afat, se për planin kombëtar për emergjencat civile është propozuar afati 2-vjeçar. Kur të shkojmë te neni 72, kur do të merremi me afatet për çdo akt, ne mund ta fusim edhe pikën 8, që normalisht do të ndodhë pasi të miratohet plani kombëtar dhe të lëmë një afat që është afati minimal i njohjes së një plani që mund të jetë 3-mujor apo 1-mujor, nuk e di, por them ta reflektojmë vërejtjen tuaj atje dhe në varësi të faktit se çfarë do të vendosim ne si afat për planin kombëtar.

Kush është dakord me nenin 14? Faleminderit!

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 14.

Kalojmë te neni 15 “Sistemi i mbrojtjes civile”.

Kush është dakord me nenin 15? Faleminderit!

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 15.

Kalojmë te neni 16.

Përpara se të kalojmë te neni 16 do të doja të bëja një vërejtje që, në qoftë se në numërtim përdorim numra romakë, i njëjti sistem do të përdoret edhe për numërtimin e seksioneve. Pra, krerët dhe seksionet numërtohen me numra romakë.

Këtu bëhet fjalë për institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile, që fillojnë që nga Kuvendi e të gjitha me radhë.

Në germën “b” të këtij neni ju keni thënë “Këshilli i Ministrave”, ndërkohë në germën “dh” thoni “ministritë dhe institucionet qendrore”.

A ka përsëritje këtu? Unë do të isha e mendimit të linim germën “dh” si germë “b”, sepse KM-ja i nënkupton ministritë.

Urdhëroni, zoti Shehu!

Ismail Shehu – Faktikisht, kompetencat janë të ndara, pa lënë hapësira për konfuzione. KM-ja i ka të qarta kompetencat e veta: miratimi i strategjive, i dokumenteve të vlerësimit të riskut, shpallja e gjendjes së fatkeqësive natyrore e të tjera. Këto janë të ndara me thikë me atë çka bën Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme e të tjera.

Ermonela Felaj – Pra, ju keni parasysh KM-në si një etnitet dhe ministritë si të ndara. Dakord. Faleminderit!

Ndërkohë po ju referoj vërejtjen e përcjellë nga Komisioni i Ligjeve. Ky komision ka parashikuar që të hiqet germa “a”, që përcakton Kuvendin si pjesë e strukturave të mbrojtjes civile, sepse Kuvendi nuk është një strukturë ekzekutive.

Haki Çako – Ne jemi republikë parlamentare dhe në këtë këndvështrim parlamenti i Shqipërisë është institucioni më i lartë dhe më vendimmarrës në këtë vend. Ligji ka përcaktuar qartë edhe vendimmarrjen, edhe shqyrtimet rast pas rasti të fatkeqësive natyre apo fatkeqësive të tjera gjendjen e shpalljes së fatkeqësive dhe afatet.

Brenda në ligj ka një detyrim që qeveria brenda një muaji gëzon të drejtën e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, ndërkohë që për mbi 1 muaj vendos Kuvendi. Për sa kohë ka disa fragmente të cilat e përfshijnë Kuvendin e Shqipërisë, nuk ka asnjë gjë të keqe që gjithçka të fillojë nga Kuvendi, as më tepër që më tepër që gjithë ky ligj nuk ka të bëjë me sistemin ekzekutiv, por është një ligj që ka të bëjë me sistemin total të mbrojtjes civile. Nuk është çështje strukturash as ekzekutive dhe as ligjvënëse apo struktura të tjera.

Në kompleksitetin e vet ligji është ligj i një sistemi të mbrojtjes civile, ku detyrimet janë të të gjitha institucioneve, të të gjitha subjekteve dhe çdo qytetari në këtë vend.

Ermonela Felaj - Urdhëroni, zoti Shehu!

Ismail Shehu – Komisioni i Ligjeve e kaloi edhe pikën “a” edhe nenin specifik të Kuvendit. Qe një debat fillestar kur u diskutua në parim, ndërsa në miratimin nen për nen ramë dakord që të mbeten si dispozita.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Zonjën Duka e kam këtu për të ma konfirmuar, meqenëse ka marrë pjesë në diskutimet e Komisionit të Ligjeve.

Valentina Duka - Faleminderit!

Nga relatori i këtij projektligji në Komisionin e Ligjeve u propozua që të hiqej Kuvendi dhe unë vetë i qëndroj këtij propozimi, pasi nëse do t'i referohemi nenit 16, kemi institucione dhe struktura qendrore të mbrojtjes civile.

A mund ta konsiderojmë Kuvendin një institucion të mbrojtjes civile?

Pavarësisht detyrimeve që ka Kuvendi, detyrime që ia jep Kushtetuta, që ia japin ligjet e posaçme, nuk mund ta konsiderojmë si një institucion të mbrojtjes civile.

Unë i qëndroj propozimit për ta hequr Kuvendin. Gjithashtu, i qëndroj propozimit që neni 17 të mos jetë, sepse ne flasim për parime kushtetuese.

Për sa i përket Komisionit të Ligjeve, është propozuar që Kuvendi të hiqet nga institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile.

Ermonela Felaj – Atëherë në raportin që kam unë përpara është propozuar që të hiqet neni 16 dhe 17 të hiqen.

Valentina Duka – Te neni 16 bëhet fjalë për pikën “a”, kurse neni 17 të hiqet fare.

Ermonela Felaj – Do të doja opinionin e relatorit.

Sadi Vorpsi – E nderuar zonja kryetare,

Ky projektligj është një risi për vendin, e para.

E dyta, për vetë situatën që ne kemi kaluar dhe po kalojmë që nga viti 1991 deri sot, situatë e vështirë edhe për shkak për paligjshmërisë dhe, duke e marrë në retrospektivë, mendoj se përfshirja e Kuvendit është shumë me vlerë.

Këtu ka një pikë që unë e vlerësoj, ku thuhet se ushtron kontroll parlamentar për çështjet që kanë lidhje me mbrojtjen civile. Kjo pikë është shumë e rëndësishme, mendoj unë, prandaj do t'i rrija propozimit të ministrisë për ta përfshirë Kuvendin në këtë projektligj.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Unë mendoj të hedhim në votim dhe të miratojmë variantin e paraqitur nga qeveria.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Jam e detyruar ta hedh në votim, duke nisur nga propozimi më i largët.

Njëri propozim është që neni 16 t'i hiqet germa “a” dhe me këtë rast vendosim edhe për nenin 17, i cili është propozuar që të hiqet me idenë se Kuvendi i ka detyrimet e përcaktuara.

Diskutimi që është bërë paraprakisht në Komisionin e Ligjeve është se a është Kuvendi i Shqipërisë institucioni i mbrojtjes civile (meqenëse se ka një nen në ligjin për mbrojtjen civile, ku thuhet se institucionet dhe strukturat qendrore të mbrojtjes civile janë Kuvendi, KM-ja e të tjera me radhë.

Neni 17 parashikon disa detyrime të Kuvendit për të cilat thuhet se janë në Kushtetutë dhe për rrjedhojë nuk ka nevojë të përsëriten në ligj.

Ky është qëndrimi që duhet të mbajmë. A duhet ta përfshijmë Kuvendin kështu siç është propozuar apo jo?

Pasi ka diskutuar, Komisioni i Ligjeve i ka lënë siç janë. Ndërkohë, në raportin që unë kam përpara është bërë ky diskutim. Gjithsesi e bëjmë edhe në këtë diskutim, meqenëse ka një kolege që mbron këtë variant.

Myslim Murrizi – Besoj se gjendjen e jashtëzakonshme e shpall qeveria, kurse zgjatjen e afatit të gjendjes së jashtëzakonshme ta bëjë Kuvendi.

Vetëm për faktin se mund të jemi para situatave të jashtëzakonshme me afat kohor më të gjatë se ç’ka tagër qeveria, le të jetë edhe Kuvendi.

Ermonela Felaj – Atëherë, me sa kuptoj nga qëndrimet e kolegëve dhe të ministrisë, ideja është që të qëndrojë neni 16 dhe 17 siç janë propozuar.

Kush është dakord me nenin 16?

Faleminderit! Kundër? Abstenim?

Miratohet kështu siç është.

Kush është dakord me nenin 17?

Faleminderit! Kundër? Abstenim?

Ka një kundër që është parimore, nuk është në kuptimin e përmbajtjes.

Miratohet kështu siç është.

Kalojmë te neni 18 që ka të bëjë me detyrimet e KM-së në raport me këtë ligj.

Elona Gjebrea - Faleminderit!

Te pika “d” ku thuhet “kërkon pëlqimin e Kuvendit”, të thuhet “miratimin”, meqenëse edhe në fillim thuhet se KM-ja miraton dhe siguron.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Shehu!

Ismail Shehu – Kjo është marrë nga Kushtetuta, por nuk prish asnjë lloj pune. Për ne nuk është problem.

Ermonela Felaj – Ndërkohë do ta pasoj edhe unë sugjerimin e zonjës Gjebrea, që në germën “d” të thuhet: “informon Kuvendin e Shqipërisë nëpërmjet ministrit përgjegjës për situatën e krijuar”.

A jeni dakord që reflektojmë edhe këtë sugjerim te kjo germë?

Normalisht duhet të ketë një ministër që ta informojë parlamentin në emër të KM-së për situatën e krijuar. Meqenëse ministri përgjegjës është ministri i Mbrojtjes, normalisht ai duhet të vihet në lëvizje i pari, që të mos kemi diskutime se cili ministër duhet të informojë.

Kush është dakord me propozimet e bëra për germën “d” të nenit 18?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 18?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 18.

Kalojmë te neni 19, “Komiteti ndërministror i emergjencave civile”.

A ka ndonjë vërejtje nga kolegët?

Kush është dakord me nenin 19?

Faleminderit! Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 19.

Kalojmë te neni 20.

Për nenin 20 kam vetëm një sugjerim nga Komisioni i Ligjeve, që në pikën 2 të këtij neni në vend të fjalës “kryeministritë” të përdoret “Këshilli i Ministrave”.

A jemi dakord që në nenin 20 të reflektohet ky sugjerim i Komisionit të Ligjeve dhe ky nen të miratohet siç është?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 20.

Kalojmë te neni 21, “Ministri përgjegjës për mbrojtjen civile”.

Kush është dakord me nenin 21?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 21.

Elona Gjebrea – Meqenëse ne futëm Kuvendin si institucion i strukturave qendrore, ndoshta duhet të bëhet: “...të raportojë përpara Kuvendit periodikisht”.

Ermonela Felaj – Ne e kemi atë pjesë, se duke qenë ministër i Mbrojtjes që raporton në këtë Kuvend, nuk ka ligj që t’ia heqë këtë detyrim.

Kalojmë te neni 22, “Ministritë dhe institucionet qendrore”.

Udhëroni!

Elona Gjebrea – Kam një pyetje. A mos duhet edhe Ministria e Arsimit në rastet kur ka një fatkeqësi të zgjatur dhe ka nevojë që personat e evokuar, rrinë aty për një kohë të gjatë dhe mos ta humbin të drejtën e arsimimit?

E dyta, nuk e kuptoj pse thuhet “ministra përgjegjëse për mjedisin” pastaj thuhet “pyjet, kullotat, zonat e mbrojtura mjedisore”. Nëse thuhet “për mjedisin” janë të përfshira. Unë mendoj se është e tepërt.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Ismail Shehu – Kjo dispozitë është bërë duke rakorduar me të gjitha ministrinë e linjës dhe secila ministri, sipas fushës së përgjegjësisë, ka bërë sugjerimet e saj.

Nuk është lënë vetëm “mjedisi” pasi është strukturuar në këtë formë ministria përkatëse, që mund të ketë këto fusha. Nesër mund të ndahen ndryshe fushat e përgjegjësisë dhe duke qenë se janë fusha delikate që kanë ndjeshmëri për çështje të mbrojtjes civile janë dhënë specifikisht me emërtesa.

Ndërsa për pyetjen e parë për arsimin, vetëm Ministria e Arsimit nuk hynë në institucione që do të bëjnë plane emergjence për çështjet e arsimit, sepse realisht nuk ka lidhje me këtë çështje.

Ministria e Arsimit futet (do ta shohim te dispozitat e mëvonshme) dhe merret me çështjet e kurrikulave, me çështjen e arsimimit, bashkëpunimin mes universiteteve e të tjera, pro hartim plani për emergjencat civile për arsimin realisht nuk ka. Edhe vendet e tjera të BE-së që ne i kemi marrë shembull për hartimin e këtij ligji nuk e kanë një diçka të tillë.

Elona Gjebrea – Në qoftë se do të ecim me këtë logjikë, për pjesën e pyjeve dhe kullotave, i bie që edhe ministrinë e tjera mund të kenë ristrukturime dhe mund të vazhdojë pa fund kjo gjë. Për sa kohë e kemi këtu e themi “ministra përgjegjëse për mjedisin” dhe nuk ka njeri që mund të thotë se pyjet dhe kullotat nuk futen si pjesë e përgjegjësisë së ministrisë...

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj - Mua më shqetëson më shumë vërejtja juaj për Ministrinë e Arsimit. A duhet ta përfshijmë Ministrinë e Arsimit në rrethin e institucioneve qendrore që kanë detyrim për të bërë plane për emergjencat civile apo jo?

Maksimilian Dhima – Fushat e përgjegjësisë së Ministrisë së Arsimit që kemi marrë në konsideratë nuk konvergojnë me detyrimet e emergjencave civile. Gjithsesi, ajo që tha më parë edhe zoti Shehu, këto do të përfshihen me hartimin e kurrikulave të trajnimeve dhe gjithçka tjetër.

Për sa u përket pyjeve dhe kullotave, tashmë edhe me ligjin e ri dhe ndarjen administrative, një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve dhe e përgjegjësisë të pyjeve,

kullotave, ujëmbledhësve dhe liqeneve i kanë kaluar edhe pushtetit lokal, kështu që në mënyrë të vazhdueshme mund të ndryshojnë edhe detyrimet dhe specifikat, prandaj është marrë në konsideratë dhe është pasqyruar kjo gjë.

Ermonela Felaj – Megjithatë, duke parë përmbajtjen e germave të tjera, më lind e njëjta pyetje. Nëse ne i themi ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë të marrë masa për kalueshmërinë pa ndërprerje të akseve rrugore, të monitorojë prurjet në ujëmbledhës, të sigurojë furnizimin pa ndërprerje me energji elektrike, emergjencat civile mund të prekin edhe funksionimin e shkollave. A nuk ka ndonjë detyrim Ministria e Arsimit në këtë rast?

Maksimilian Dhima – Nuk kushton asgjë dhe mund ta shtojmë sugjerimin tuaj. Jemi dakord.

Ermonela Felaj – Dakord. Do të na duhet të shtojmë një germë, ku i japim detyrimin Ministrisë së Arsimit, që në rastet e emergjencave civile të marrë çdo masë për të vijuar procesin mësimor pa ndërprerje.

Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Te pika 4 e këtij neni thuhet shprehimisht: “Çdo ministri ka pozicione pune deri në nivel sektori për mbrojtjen civile, përbërja dhe detyrat e të cilave miratohen me vendim të KM-së dhe propozim të ministrit”.

Pra, ministria mund të ketë vetë një strukturë që merret me këtë punë dhe s’është nevoja që ne të shtojmë.

Ermonela Felaj – Unë mendoj se ne, përderisa për ministrinë e tjera kemi përdorur detyrime specifike se çfarë masash marrin, nuk ka pse të përjashtojmë Ministrinë e Arsimit.

Me të drejtë kolegja Gjebrea më kujton pikën 8 të nenit 14, që e detyron edhe Ministrinë e Arsimit të hartojë plan për emergjencat civile.

Me një fjali, që Ministria e Arsimit kujdeset për vijimin e rregullt të procesit mësimor në të gjithë vendin, ne e mbylлим këtë detyrim.

Ismail Shehu – Neni 22, pika 2, thotë: “Ministrinë dhe institucionet qendrore kanë këto detyrime...”. Këtu përfshihet edhe arsimit.

Pika “a” thekson se ato hartojnë dhe miratojnë planin për emergjencat civile dhe këtu përfshihet edhe Ministria e Arsimit. Pra, këtu nuk ka ndarje këtu janë të gjitha ministrinë.

Më poshtë është për detyrimin buxhetor.

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Për sa kohë ne jemi dakord që objektet arsimore nuk kanë imunitet nga fatkeqësitë, nuk ka kuptim që Ministria e Arsimit të jetë pa asnjë detyrim dhe këto detyrime i paskan bashkitë.

Bashkitë kujdesen për godinat, kurse për mësuesit, për tekstet mësimore (se mund të digjen të gjitha tekstet dhe mjetet mësimore) nuk vihet në lojë bashkia, por Ministria e Arsimit.

Unë kam një pyetje për germën “b”. Ju keni thënë që institucionet qendrore kanë për detyrë të planifikojnë nga buxheti vjetor i tyre 2-4% të totalit të buxhetit për përballimin e emergjencave civile. Në germën “ç” keni lënë afatin 3-vjeçar, që baza e të dhënave për humbjet dhe fatkeqësitë e shkaktuara më herët të krijohet në afatin 3-vjeçar nga hyrja në fuqi e këtij ligji për çdo institucion.

Ky afat mos është i gjatë? Sepse ka një rekord të dhënash, ndërkohë që çdo ministri mund ta mbledhë në një kohë më të shkurtër se 3 vjet dhe ta vërë në dispozicion Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sepse ato do të mbledhin rekordet për fushën e tyre dhe atë do t’ua vënë në dispozicion.

Pra, e kam ndërhyrjen për afatin 3-vjeçar dhe për planifikimin buxhetor. A është e mjaftueshme 2-4%? Mos duhet ta vëmë këtu 4%?

Ismail Shehu – Është lënë 4 për arsye se ndodh që nj ministri mbulon 2 ose më shumë nga këto fusha që janë të përcaktuara në ligj dhe në varësi se sa përgjegjësi ka secila, ka edhe një diapazon vendimmarrjeje.

Ermonela Felaj – Dakord.

Po afati 3-vjeçar, si ju duket zoti Çako?

Haki Çako – Për afatin 3-vjeçar është pasur në konsideratë krijimi i një sistemi të caktuar të dhënash, lidhur me informacionin që do të administrojë Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Pra, duhet të krijohet një sistem i caktuar i bazës së të dhënave. Ne mund ta ulin edhe në 2 vjet, por kjo është e kushtëzuar nga mundësitë reale që do të ketë pikërisht ky sistem.

Presupozohet që të jetë një sistem i ngjashëm me TIMS-in të Policia e Shtetit ose një sistem unik kombëtar.

Ermonela Felaj – Atëherë, a jeni dakord ta lëmë 2 vjet?

Dakord.

Pra, sugjerohet që të shtohet Ministria e Arsimit dhe sipas përmbajtjes së nenit kjo ministri duhet të shtohet edhe në përmbajtje të germës “b”, të pikës 2 të këtij neni.

Germa “ç” e pikës 2 e afatit 3-vjeçar të bëhet 2-vjeçar.

Të shtohet një germë në pikën 3, germa “f”, për Ministrinë e Arsimit, e cila duhet të marrë masa për mosndërprerjen e procesit mësimor ose për vijimin e procesit mësimor.

A jemi dakord me këto tre sugjerime?

Kush është dakord?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 22.

Vazhdojmë me nenin 23, “Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile”.

Ky është një nen i gjatë. Unë do të sjell në vëmendje pikën 7 të këtij neni, për të cilën në nenin 72 ka një afat, që është afati 1-vjeçar për miratimin e strukturës së organikës së AKMC-së.

Për këtë pikë të këtij neni propozohet afati 1-vjeçar për nxjerrjen e aktit. Sigurisht, afatin ne do ta diskutojmë te neni 72, por ju ftoj që ta mendoni dhe do të doja edhe një koment paraprakisht të zotit Çako. A ju duket i arsyeshëm ky afat

Haki Çako – Ne do të sugjeronim 6 muaj.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Nisur nga një eksperiencë personale me UNFP-në, që është një organizatë e UN-së, e cila merret me çështje të shëndetit, mbaj mend se ne kemi qenë shumë të angazhuar për të bashkëpunuar dhe ata ofronin edhe mbështetje të ndryshme për struktura të emergjencave civile. Mendoj se nuk duhet ta kufizojmë pjesën e OJF-ve, mund ta themi “brenda dhe jashtë vendit”, sepse ju ndihmon edhe juve për gjithë ato organizata ndërkombëtare, të cilat ofrojnë mbështetje. Bëhet fjalë për germën “g” të pikës 6.

Ermonela Felaj – Dua një mendim nga ministria.

Ismail Shehu – Dakord jemi me sugjerimin.

Elona Gjebrea – Sugjerimi i dytë është për ta përforcuar, që “qendra e trajnimit për mbrojtjen civile” mund të jetë “qendra kombëtare”, sepse kështu si është duket se edhe qendra të tjera mund të kenë mbrojtje civile dhe do të krijohet konfuzion.

Ermonela Felaj – Ju lutem, një mendim nga Emergjencat Civile!

Haki Çako – Dakord jemi. Është një ndihmë e madhe ky sugjerim i zonjës Gjebrea.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea për sugjerimet konstruktive!

Kush është dakord me nenin 23, me dy sugjerimet e zonjës Gjebrea për germën “a” dhe “g”?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 23.

Kalojmë te neni 24, “Drejtori i përgjithshëm i AKMC-së”.

Ju zoti Çako a keni ndonjë koment?

Haki Çako – Nuk kam asnjë koment.

Ermonela Felaj – A ka ndonjë ndërhyrje nga kolegët? Nuk ka.

Kush është dakord?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 24.

Kalojmë te neni 25, “Komisioni teknik këshillimore”.

Unë kam një pyetje për zotin Çako. Pse është e domosdoshme që detyrat, përbërja dhe funksionimi i një komisioni teknik që juve ju këshillon të përcaktohet me vendim të KM-së dhe të mos përcaktohet nga ju si agjenci?

Haki Çako – Ka një vendim të KM-së, vendimi nr. 965, i cili përcakton këtë kompetencë.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Shehu!

Ismail Shehu – Duke qenë ndërinstytucional nuk mund të dalë me një urdhër të drejtorit të përgjithshëm të AKMC-së, që urdhëron, mbledh dhe këshillon përfaqësues nga të gjitha institucionet e tjera.

Ermonela Felaj – A mund ta bëjmë “miratohen” jo “përcaktohen”?

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Edhe unë jam dakord me mendimin tuaj, kryetare, se funksioni që ka ky komision është minimal, vetëm këshillon për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive. Mendoj se është kompetenca e drejtorit të përgjithshëm që të urdhërojë këtë komision, pavarësisht se e kuptoj që keni këto përplasjet.

Ermonela Felaj – Në fakt, bëhet fjalë që nën drejtimin e AKMC-së në ministrinë përgjegjëse krijohet ky komision teknik këshillimor.

Ndërhyrja që bën zoti Shehu për pozicionimin e AKMC-së në këtë rast, një institucion ndërveprues, besoj se e justifikon propozimin siç ka ardhur, por do të isha e mendimit që ta bëjmë “miratohen” jo “përcaktohen”.

Urdhëroni, zonja Duka!

Valentina Duka – Për teknikë legislative do të sugjeroja, që pika 1 të rikonceptohet ndryshe.

Ermonela Felaj – Dakord nga pikëpamja gjuhësore të rregullohet “Në ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen civile, nën drejtimin e AKMC-së, krijohet dhe funksionon komisioni, i cili këshillon për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive”.

Kush është dakord me këto sugjerime në pikën 1 dhe në pikën 3?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 25.

Kalojmë te neni 26, “Qendrat e mbrojtjes civile në qark”.

Te pika 2 “përcaktohen” zëvendësohet me “miratohen”.

Ka edhe një propozim nga Komisioni i Ligjeve që miratimi i qendrave të mbrojtjes civile në qark, sa u takon detyrave dhe përbërjes, të mos bëhet me vendim të KM-së, por të bëhet nga vetë AKMC-ja.

Urdhëroni, zoti Shehu!

Ismail Shehu – Faktikisht, këto qendra do të jenë pjesë e strukturës së AKMC-së, në nivel vendor. Ideja është që një strukturë s'mund ta miratojë vetë drejtori i përgjithshëm.

Ermonela Felaj – Në fakt, përderisa themi “miratohen me vendim të KM-së”, kuptohet që propozimi nga AKMC-ja do të vijë, kështu që propozimi do të jetë formal edhe për të ruajtur integritetin, statusin e të gjithë atyre punonjësve.

Gjithsesi, kompetenca thelbësisht është në dorë të AKMC-së. Unë do të isha e mendimit që ne nga linim ligjin kështu siç është, vetëm me ndryshimin në pikën 2.

Kush është dakord?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 26.

Kalojmë te seksioni II.

Edhe këtu kam të njëjtën vërejtje për përdorimin e numrave romakë.

Neni 27, institucionet dhe strukturat e mbrojtjes civile në nivel vendor, që fillojnë nga prefekti e me radhë.

Kush është dakord?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 27.

Kalojmë te neni 28, “Prefekti i qarkut”.

Urdhëroni, zonaj Dhima!

Antoneta Dhima – Germa “a” e pikës 2 mendohet të formulohet kështu: “Të kthejë buxhetin e vitit pasardhës të bashkive, brenda territorit administrativ të tij, në rast se nuk është planifikuar 4% e buxhetit vjetor të kushtëzuar të akorduar nga buxheti i shtetit për marrjen e masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sidomos në bashkitë të cilat janë konsideruar si të rrezikuara nga emergjencat civile apo fatkeqësitë”.

Ermonela Felaj – Do të doja t'u referoj kolegëve që për nenin 28, për të njëjtën pikë, pika 2, germa “a”, ka një ndërhyrje edhe nga Komisioni i Ligjeve, që është identike pothuaj me propozimin që bën zonja Dhima, përveç faktit që sugjerohet të hiqet togfjalëshi “sidomos në bashkitë të cilat janë konsideruar si të rrezikuara nga emergjencat civile apo fatkeqësitë”, si një togfjalësh që është më shumë subjektiv se sa objektiv.

Pra, të mbetet kështu: “Të kthejë buxhetin e vitit pasardhës të bashkive, brenda territorit administrativ të tij, në rast se nuk janë planifikuar fondet buxhetore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sipas parashikimeve të nenit 65 të këtij ligji”.

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Unë jam e mendimit që ta themi këtë. Pse t’i vëmë me detyrim disa bashki, që s’kanë asnjëherë nevojë (edhe në strategjitë e riskut) të kenë këto fonde në nivelin 4%, sepse ato e bllokojnë dhe nuk e përdorin, ndërkohë që mund ta përdorin për diçka më të vlefshme?

Ermonela Felaj – Përderisa është fond i kushtëzuar, është e detyruar ta përdor vetëm për mbrojtjen civile. Nëse nuk e përdor do të digjet, do kthehet mbrapsht.

Mendoj se me situatën aktuale çdo bashki ka nevojë për një fond të tillë.

Urdhëroni, zonja Duka!

Valentina Duka - Faleminderit!

Edhe në Komisionin e Ligjeve u bë një debat i gjatë lidhur me këtë pikë, pasi nga zoti Fino u pretendua se është një ndërhyrje në kompetencat e bashkive. Megjithatë, unë jam e mendimit se duhet të qëndrojë, pasi, siç nga rezulton nga bashkitë, nuk është përdorur asnjëri fondi për emergjencat civile.

Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Meqenëse u diskutua paraprakisht përpara se të fillonte komisioni, mendoj që të mos hiqet pjesa e fundit e fjalisë, por të thuhet: “bashki që janë konsideruar si të rrezikuara nga emergjenca civile ose fatkeqësitë, të planifikojnë nga të ardhurat e veta fonde shtesë për të përballuar këto raste emergjencash civile”.

Ermonela Felaj – Mund të kemi problemin e akteve që përmendëm, që në moment nuk kemi një planifikim të këtyre bashkive. E rëndësishme është që ta vlerësojnë vetë.

(Diskutime pa mikrofon)

Në fakt, ju jeni të ftuar, por meqë ne njihemi si komision tolerant, po jua jap fjalën.

Xhelil Cibaku – Jam inspektor në Ministrinë e Brendshme, agjencia për mbështetjen e qeverisjes vendore.

Edhe në Komisionin e Ligjeve ne e trajtuam këtë çështje dhe ne jemi të mendimit që ky 4%-ësh, si fond i kushtëzuar, që miratohet nga qeveria, nuk ka nevojë dhe nuk është kompetencë për t’u miratuar ose jo nga këshilli i bashkisë.

Ky 4%-ësh duhet të jetë i padiskutueshëm. Është njësoj si zëri për arsimin, për mbrojtjen nga zjarri e me radhë, pra ky është minimumi dhe nuk është kompetencë e këshillit të bashkisë që ta diskutojë këtë, sepse është miratuar në buxhetin qendror.

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Prefekti e ka të drejtën për të kthyer buxhetin, por ai e kthen në momentin kur atë 4%-shin që është lënë për mbrojtjen civile, nuk e përkthen në rrugë, në ura të tipit “Bejli”, në kanale e të tjera me radhë...

(Diskutime pa mikrofon)

Meraku ynë si ligjvënës është që bashkitë të kenë një detyrim të përcaktuar. Meqenëse fondet vijnë nga qeveria, duhet të ketë institucionin e vet nëpërmjet të cilit e kontrollojnë mënyrën e përdorimit të këtyre fondeve.

Do t’i ftoj kolegët të ndalemi edhe një moment tjetër.

Urdhëroni, zoti Vorpsi!

Sadi Vorpsi – Jam plotësisht dakord me sugjerimet e kolegëve. Dëgjova edhe zotërinë që vjen nga Ministria e Brendshme dhe e kam të qartë që Shoqata e Prefektëve ka qenë gjithmonë lobuese.

Unë personalisht do të doja të shtoja para pikës 11, ku thuhet “institucioni i prefektit monitoron zbatimin e masave të marra nga bashkitë e qarkut për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile”.

Te pika “1” duhet të vihet fjala “kontrollon”, pra “kontrollon zbatimin e masave të marra nga bashkitë e qarkut për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile”.

Ermonela Felaj – A kemi ndonjë koment për këtë sugjerim?

Haki Çako – Jemi shumë dakord me këtë propozim.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Kam një ndërhyrje për afatet. Ne i kemi lënë prefektit 3 vjet në dispozicion për të vlerësuar riskun brenda një territori, 3 vjet për të bërë bazën e të dhënave, ndërkohë që i lamë 2 vjet institucioneve qendrore, që e kanë në rang kombëtar?

A t’i lëmë 1 vit kohë prefektit, se me qarkun do të merret?

Si mendoni zoti Vorpsi?

(Diskutime pa mikrofon)

Si mendoni zoti Çako!

Haki Çako – Do të duhet të përkojë me afatin e bashkive dhe do të ishte normale dy me dy.

Ermonela Felaj – Dakord.

Atëherë në përmbajtjen e këtij neni, te germa “b” dhe “gj”, afati 3 vjet bëhet 2 vjet, sipas propozimit.

Në germën “1” fjala “monitoron” zëvendësohet me “kontrollon”.

Germa “a” do të ketë përmbajtjen e propozuar nga Komisioni i Ligjeve dhe të sugjeruar nga sekretarja e komisionit, zonja Dhima.

Kush është dakord?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 28.

Kalojmë te neni 29.

Fjala “përcaktohet” bëhet “miratohet”.

Kush është dakord me nenin 29, me ndryshimin e bërë në pikën 3?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 29.

Kalojmë te neni 30, që bën fjalë për detyrimet që kanë bashkitë në situatën e emergjencave civile.

A ka ndonjë sugjerim për këtë nen?

A mundemi edhe që edhe këtu, në germën “a”, afatin 3-vjeçar ta bëjmë 2-vjeçar?

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Te germa “i” fjalën “akumulojnë” ta zëvendësojmë me “mbledhin”.

Ermonela Felaj – Dakord. Mund ta zëvendësojmë me fjalën shqipe këtë fjalë të huaj.

Urdhëroni, zonja Xhina!

Elena Xhina – Do të sugjeroja diçka për titullin.

Ismail Shehu – Duhet të jetë “njësitë e vetëqeverisjes qendrore”, siç e ka ligji për pushtetin vendor.

Ermonela Felaj – Po i përmbledh sugjerimet për këtë nen.

Afatin 3-vjeçar që përmendet në germën a” dhe në germën “ë” do ta bëjmë 2 vjet.

Kemi propozimin e zonjës Gjebrea që te germa “i” fjalën “akumulojnë” ta zëvendësojmë me “mbledhin”.

Te germa “gj” kemi sugjerimin që të hiqet fjala “të ndryshme”, meqenëse fjala “fatkeqësi” është te përkufizimet.

Kush është dakord me nenin 30 me të gjithë këto sugjerime?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 30.

Kalojmë te neni 31.

Kush është dakord me nenin 31?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 31.

Kalojmë te neni 32.

Kush është dakord me nenin 32?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 32.

Kalojmë te neni 33.

Kush është dakord me nenin 33?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 33.

Kalojmë te neni 34, “FA-të e Republikës së Shqipërisë dhe detyrat që kanë ato në rastin e fatkeqësive”.

Unë do të isha për një riformulim të pikës 4, që ta ndërtojmë drejt nga ana gjuhësore. Të thuhet “Njësitë e FV-ve marrin pjesë në operacione të drejtuara nga komandantët e tyre, sipas detyrave që u ngarkohen nga drejtuesi i operacionit”.

A jeni dakord zoti Çako?

Haki Çako – Ka një problem, se si rregull ka një zinxhir komandimi, sipas të cilit ushtarakët marrin urdhra vetëm nga kuadri komandues. Ajo “kur” është pikërisht për të specifikuar që vetëm kur janë në operacionet e mbrojtjes civile, se në rastet e tjera nuk ndodh të marrin urdhra nga struktura të tjera, përveçse nga zinxhiri i tyre komandues.

Ermonela Felaj – Dakord.

Kush është dakord me nenin 34, siç është formuluar?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 34.

Kalojmë te neni 35.

Kam një ndërhyrje për pikën 2. Fjala “të vdekurve” të zëvendësohet me fjalën “viktimize”.

Dakord.

Kush është dakord me nenin 35?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 35.

Kalojmë te neni 36, “Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit”.

Kush është dakord me nenin 36?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 36.

Kalojmë te neni 37.

Kush është dakord me nenin 37?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 37.

Kalojmë te neni 38, “Shërbimi i vullnetarëve për mbrojtjen civile”.

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Te pika 1 thuhet: “Çdo shtetas i RSH-së kontribuon vullnetarisht”.

Duhet të ishte “mund të kontribuoj vullnetarisht”, se duket sikur e vë në detyrim.

Ermonela Felaj – Fjala “vullnetarisht” e zgjidh komplet problemin.

(Diskutime pa mikrofon)

Te pika 3 fjala “përcaktohet” bëhet “miratohet”.

Kush është dakord me nenin 38?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 38.

Kalojmë te kreu IV, që është “Gjendja e fatkeqësisë natyrore dhe masat e jashtëzakonshme”. Neni 39.

Kush është dakord me nenin 39?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 39.

Kalojmë te neni 40, “Kategorizimi i emergjencave civile”.

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Te pika 1 thuhet: “EC-të në bazë të intensitetit të shtrirjes së efekteve të fatkeqësisë”, ndërkohë ne po flasim për risqe e të tjera, e të tjera, të cilat mund të përcaktohen shumë mirë në një dokument tjetër, në të gjithë ato dokumente që prodhohen. Më duket si pa kuptim dhe jo e qartë. Ndoshta ju që jeni më ekspertë e sqaroni.

Ermonela Felaj – Në fakt, do ta mbështes edhe unë sugjerimin e zonjës Gjebrea. Çfarë na pengon të jemi më konciz në formulimin e pikës 1?

Ne mund të themi “EC-të kategorizohen në”, ndërkohë që ju e keni dhënë përmbajtjen për secilën dhe nuk ka nevojë të thoni “në bazë të kësaj, në bazë të asaj”, sepse e ke në përmbajtje dhe vetëkuptohet pse e ke ndarë në atë mënyrë.

Në të vërtetë, nga pikëpamja gjuhësore fjali nuk duke e gjetur.

Haki Çako – Dakord jemi. Ka edhe shabllonizma nganjëherë.

Ermonela Felaj – Dakord.

Bëjmë korrigjimin për pikën 1 dhe për pikën 3 fjala “përcaktohen” bëhet “miratohen me vendim të KM-së”.

Kush është dakord me nenin 40 me të dyja këto ndërhyrje?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 40.

Kalojmë te neni 41, që bën fjalë për të drejtën e kompensimit.

Te pika 4, do të kisha një pyetje, nëse relatori nuk ka ndonjë ndërhyrje. Pse ia kemi lënë detyrimin me “mund” Komitetit të Mbrojtjes Civile?

Unë mendoj se Komiteti i Mbrojtjes Civile ndërhyr dhe duke ndërhyrë, vendos nëse tejkalmi 8% është real apo joreal. Në momentin që e pranon që është real, do ta merrni ju detyrimin, nëse nuk është, do ta vazhdojnë ato.

Urdhëroni, zoti Vorpsi!

Sadi Vorpsi – Te pika 4 thuhet që, në rast se vlera e kompensimit tejkalon 4% të buxhetit të bashkisë, jo 8%.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Në lidhje me “mund” unë mendoj se duhet të themi “vlerëson”.

Ermonela Felaj – E themi direkt “vendos”. Kështu e ka propozuar edhe Komisioni i Ligjeve.

Në lidhje me sugjerimin e zotit Vorpsi, mund të them se, nëse ne ia kemi detyrimin 4%, pse duhet 8% këtu?

Ismail Shehu – Gjithë ideja është që bashkitë janë primare që ndërhyjnë në raste emergjencash civile, ndërkohë që janë të parat që marrin përsipër përgjegjësinë për shpërblimin e dëmeve familjarëve nga një fatkeqësi.

Logjika pas kësaj është që deri në 8%, në 1 vit apo në 2 vjet, ti arrin të realizosh kompensimin e dëmeve. Nëse ky dëm shkon deri në masën 8% të buxhetit vjetor të një bashkie, pra sa dyfishi i asaj që ka kapacitet, atëherë është e qartë se bashkia nuk ka më mundësi reale për të përballuar ato as për një vit, as për dy vjet. Në këtë rast, automatikisht, hyn mekanizmi dhe futet qeverisja qendrore dhe gjithë këto dëme i merr përsipër ajo, duke realizuar interesat dhe të drejtat e qytetarëve.

Por 8%-shi është minimalja, sepse 1 vit apo 2 vjet është një procedurë standarde, duke llogaritur sasinë e fatkeqësive në të gjitha bashkitë dhe kostot që kanë. Realisht shkojnë 5-6 vjet, por duke i vënë këtë kufi, maksimalisht brenda 2 vjetëve ndërhyr qeverisja qendrore dhe kompenson qytetarin.

Me 4% apo me 5-6%, është vetë bashkia në gjendje ta përballojë. Në mos brenda vitit të parë, brenda vitit të dytë e përballon. Nëse shuma e dëmeve nga fatkeqësitë shkon deri në

8%, pra sa dyfishi, atëherë detyrimisht ndërhyjnë qeverisja qendrore, sepse bashkia e ka të pamundur ta realizojë.

Ermonela Felaj – Fakti i kanë apo nuk i kanë, nuk i pengon t'i drejtohen Komitetit të Mbrojtjes Civile. Komiteti e vlerëson. Nëse e kuptoj drejt, nuk është se do të presin dy vjet dhe pastaj po s'e shlyen do t'i drejtohen. Që në fillim mund të jetë e dukshme se s'kanë mundësi, por gjithsesi do ta vlerësojë dikush tjetër.

Urdhëroni, zoti Vorpsi!

Sadi Vorpsi – Unë prapë jam pak i paqartë për këtë, duke i ditur kapacitetet që kanë bashkitë sot.

Ermonela Felaj – Unë mendoj se është më mirë t'i bëjmë më pjesëmarrëse bashkitë në këtë proces dhe më të detyruara, përderisa detyrimi fillon prej aty, është si ajo shprehja që hallet e një shtëpie i di zoti i shtëpisë.

Haki Çako – Aktualisht, ne kemi të mbartura detyrime financiare që prej vitit 2016 e më parë dhe detyrimi ynë financiar në raport me ato çfarë do të mund të bënim në minimumin e mundshëm bashkitë është në ekstrem. Kjo është arsyeja që është marrë në konsideratë kjo përlllogaritje. Gjithsesi, bëhet fjalë për vlera kompensimi dhe nuk bëhet fjalë për buxhetim, që të jemi të qartë.

Nëse, për një afat kohor 2-vjeçar, nuk do të jetë në gjendje bashkia të kompensojë vlerën prej 4% në vit, të të dyja buxheteve të akorduara nga qeveria, atëherë jemi të detyruar të ndërhyjmë se sigurisht është një domosdoshmëri për t'i ardhur në ndihmë gjithë komunitetit që është rrezikuar nga një fenomen i caktuar.

Ermonela Felaj – Kam edhe një pyetje. Te pika 6 do të lindë përsëri problemi i afatit. Pra, masa e kompensimit të dëmit, procedurat, afatet, strukturat shtetërore, që janë përgjegjëse për vlerësimin e dëmit, si dhe pasuritë dhe subjektet që kompensohen përcaktohen me VKM (që do ta themi “miratohen”), por në pikën 1 të nenit 72, ju për pikën 6 të nenit 41 keni përcaktuar afatin dyvjeçar, pra i keni lënë dy vjet kohë Këshillit të Ministrave që të përcaktojë masën e kompensimit. A mos ju duket shumë ky afat, se nuk është se qeveria nuk ka kompensuar dhe nuk e njeh formatin dhe procedurën e kompensimit. Deri tani, ka 18 vjet që njerëzit janë kompensuar në raste të ndryshme, janë kompensuar edhe dëme që janë lënë, fjala vjen, nga viti 2010 pa kompensuar dhe janë kompensuar më vonë. A mund të kemi parasysh këtë afat?

Haki Çako – Te pjesa e afateve, ato vendime që janë të reja, pra që i krijon si detyrime ky ligj, është shumë e drejtë, siç bëme edhe në nenin e kaluar, që të vihen afate më të afërta.

Të gjitha këto të tjerat, vendime që aktualisht janë në fuqi, nuk do të bien deri në momentin e miratimit të të rejave për arsye se, që të nesërmen, nëse ka një emergjencë, njerëzit do të kompensohen. Pra, kjo hynë në sferën e atyre vendimeve që janë ekzistuese, por do të pësojnë ndryshime dhe përmirësime për shkak të detyrimeve të reja që vë ky ligj, por është se do të rrinë njerëzit pa kompensuar. Janë parashikuar 3 vjet, sepse janë 17 VKM, pa llogaritur udhëzimet dhe strategjitë kombëtare.

Ermonela Felaj – E kuptoj, por detyra është e institucionit qendror. Në qoftë se ju do të konsumoni mandat pa bërë detyrën, cila do të ishte përmbajtja pastaj!? Nuk po flasim për një risi, se ka një bazë dhe një eksperiencë.

Përderisa ky është një detyrim që rrjedh nga direktivat europiane, është një gjë për të cilën ne jemi cilësuar, e zeza mbi të bardhë, në progresraportet, mirë është që afatet t'i zvogëlojmë, që edhe pjesa tjetër të nënkuptojë se ne jemi për vënien në zbatim të ligjit sa më shpejt të jetë e mundur.

Me të gjitha diskutimet që bëmë për nenin 41, duke lënë pikën 4 ashtu siç është propozuar, por duke hequr fjalën “mund” dhe në pikën 6 të zëvendësojmë fjalën “përcakton” me “miraton”, kush është dakord?

Kush është dakord me nenin 41 me të dyja këto ndërhyrje?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 41.

Kalojmë te neni 42, “Masat e jashtëzakonshme”.

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Te germa “a”, pika 2, unë e thash edhe më parë, sigurinë e shtetasve në zonat e prekura nga fatkeqësitë, unë jam e mendimit që ta theksojmë, me prioritet gratë dhe fëmijët. Mendoj se duhet ta themi diku, pavarësisht se mund ta kemi në dokumente ose t'i referohet një dokumenti apo në vlerësimi strategjik që ju keni.

Te germa “d”, pika 2, ku thuhet “infeksion, epidemi, ndotje masive, burim radiacioni” të shtohet “e të tjerë”, se nuk i dihet çfarë tjetër mund të jetë që nuk është marrë në konsideratë.

Te germa “ç”, pika 3, nuk e kuptoj shprehjen “programi i emergjencave civile” dhe nuk e di nëse e kemi referuar këtë te neni 3, te përkufizimet.

Ermonela Felaj – Besoj se nuk kemi vërejtje për zëvendësimin e “ndërmarrje” me “marrjen e masave organizative” dhe as me shtimin e “e të tjera” te germa “d” e pikës 2.

Haki Çako – Ne thamë se është e përcaktuar në një nen tjetër kjo pjesa për gratë dhe fëmijët, gjithsesi në qoftë se gjykohet kështu, mund ta përsërisim. Ne nuk e shohim të arsyeshme që ta përsërisim.

Lidhur me pjesën ku thuhet “kryhet nga buxheti i shtetit programi i emergjencave civile” i referohemi nënprogramit aktual të emergjencave civile si pjesë e programit të Ministrisë së Mbrojtjes. Mund të specifikohet “programi financiar i mbrojtjes civile”, meqenëse shkojmë në të njëjtën linjë, e heqim “emergjencat civile” dhe e vëmë “programi për mbrojtjen civile”

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zonja Xhina!

Elena Xhina – Lidhur me pikën 3, për kompensimin, edhe unë i qëndroj vërejtjes, pasi mendoj se, nëse do të bëhet fjalë për kompensimin, duhet të jemi edhe pak më të qartë këtu. Këtu thuhet “kompensimi në raste të tilla kryet nga buxheti i shtetit, programi i emergjencave civile, donacione të ndryshme dhe burime të tjera”. Mua më duket sikur është shumë evazive, nëse do të marrim përsipër të flasë për kompensim kjo dispozitë.

Së dyti, nuk e kuptoj detyrimin që kanë subjektet private dhe shtetasit për t’u informuar lidhur me të dhënat që ndihmojnë institucionet publike dhe strukturat për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë. Çfarë detyrimi kanë shtetasit?

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Ismail Shehu – Ky ligj është konceptuar si angazhim i të gjithë shtetasve shqiptarë, përfshi institucionet, subjektet private dhe qytetarët. Në momentin kur ti ke një informacion, ka rrëshqitur dheu, ka rënë zjarr e tjera, në të gjitha këto raste ti do të kesh detyrimin tashmë të informosh, të jesh aktiv, edhe për përballimin.

Ermonela Felaj – Edhe me Kushtetutë, neni 26, shtetasit detyrohen në rastet e fatkeqësive të japin kontributin e tyre. Mund të jetë një subjekt privat dhe e gjeneron fatkeqësinë dhe të dhënat konkrete se si mund të përballohet mund t’i disponosh prapë ti, kështu që në këtë rast ti ke detyrim t’i japësh këto të dhëna, pra burimi nga vjen, shkaku, shpërndarjen që ti ke të atij rreziku në territor e që duhet ta evitosh kudo.

Elena Xhina – Jam shumë dakord me të gjitha këto që u thanë, por këtu flitet vetëm për të dhënat që disponohen. Do të isha shumë dakord për angazhimin dhe kontributin maksimal të çdo qytetari, por këtu flitet vetëm për të dhënat që mund të disponohen.

Ermonela Felaj – Atëherë, mund ta shtojmë këto fjalë: “detyrimi për të informuar lidhur me të dhënat që disponojnë”...

(Diskutime pa mikrofon)

Elona Gjebrea – Propozoj që te pika “ç” pas “kryhet nga buxheti i shtetit” në kllapa mund të vihet “programi i emergjencave civile” dhe kuptohet, se kështu duket sikur është një gjë tjetër, ndryshe nga buxheti.

Ermonela Felaj – Dakord.

Urdhëroni, zoti Hysko!

Eljo Hysko – Pyetja ime është: Në rast se unë kam një banesë të siguruar, pse shteti shqiptar përgjigjet për dëmet që shkaktohet nga një fatkeqësi? A marr dy herë para?

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Shehu!

Ismail Shehu – Nuk bëhet fjalë që të përfitosh dy herë për një dëm të shkaktuar nga një fatkeqësi natyrore. Ai person, ai subjekt privat, që është i siguruar dhe përfiton nga sigurimi, është në rregull, megjithatë shteti shqiptar nuk e përjashton në asnjë rast të mbajë përgjegjësi për gjithë qytetarët e tij. Nëse nuk përgjigjet kompania e sigurimit, në qoftë se nuk je i siguruar apo të tjera gjëra dikush duhet të përgjigjet...

(Diskutime pa mikrofon)

Haki Çako – Sepse edhe fondi i sigurimit mund të mos kapë vlera të tilla që të përballojë dëmet e shkaktuara nga një fatkeqësi natyrore, pavarësisht se ti mund të sigurohesh në një kompani, në zëra të caktuar, për pasurinë tënde, por mund të jenë tejkalaur këto, atëherë shteti merr përsipër përgjegjësitë e veta.

Ermonela Felaj – Ne e bëmë edhe dje këtë diskutim, e sugjeroi zoti Murrizi, por edhe sigurimet në përgjithësi nuk sigurojnë çdo rast, për më tepër këtu bëhet fjalë për raste fatkeqësish që vijnë papritmas, se për ato të njohurat të marrin përsipër ato të të sigurojnë, por për raste të tilla shteti jo vetëm që ka detyrime kushtetuese, por edhe për këtë shkak besoj.

Atëherë me ato vërejtje dhe sugjerime që u bënë, besoj se mund ta miratojmë nenin 42.

Kush është dakord me nenin 42 me këto ndërhyrje?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 42.

Kalojmë te neni 43.

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Meqenëse folëm për të vendosur edhe Ministrinë e Arsimit si institucion, i cili ka një përgjegjësi në pjesën e mbrojtjes civile, ndoshta mund ta shtojmë pas germës “g”, te objektet arsimore.

E dyta, është një gabim gramatikor ndoshta, te pika 2, germa “b” të thuhet “të cilat ia paraqesin agjencisë kombëtare”.

Ermonela Felaj – Ne e diskutuam çështjen e Ministrisë së Arsimit, a mund ta shtojmë te infrastruktura...

(Diskutime pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 43, duke reflektuar te germa “b” e pikës 2, në vend të fjalën “dërgojnë” të jetë “paraqesin”?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 43.

Kalojmë te neni 44, “Infrastruktura kritike me efekt ndërkufitar”.

Ju kujtoj se Komisioni i Integritetit ka bërë një përafrim si duhet, kështu që ne e kemi miratuar pak më herët.

Kush është dakord me nenin 44?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 44.

Kalojmë te neni 45.

Kush është dakord me nenin 45, ku fjala “të ndryshme” të hiqet?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 45.

Kalojmë te neni 46, “Paralajmërimi i hershëm, monitorimi, njoftimi dhe alarmi”.

Kush është dakord me nenin 46?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 46.

Kalojmë te neni 47, i cili është një nga risitë e ligjit.

Në pikën 3 kemi “miratohen” në vend të “përcaktohen”.

Kush është dakord me nenin 47?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 47.

Kalojmë te neni 48.

Kush është dakord me nenin 48?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 48.

Kalojmë te neni 49, “Informimi i publikut”.

Këtu vijmë te ajo e pyetja e zonjës Gjebrea për informimin. Ju ftoj ta shikoni me vëmendje!

Elona Gjebrea – Mendoj se përsëri te pika 1 e nenit 49 në fund të fjalisë të themi “sipas informacioneve që ato kanë”, sepse kështu duket se në mënyrë absolute ju do të informoni, por jo gjithmonë e keni informacionin dhe mund t’ju vënë para përgjegjësisë të tjerë se pse nuk na keni informuar. Thjesht, kjo është për mbrojtje.

(Diskutime pa mikrofon)

Dakord, e tërheq.

Ermonela Felaj – Ia lëmë ministrisë variantin siç e ka propozuar.

Kush është dakord me nenin 49?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 49.

Kalojmë te neni 50, “Alarmi”.

A ka ndonjë ndërhyrje nga kolegët? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 50?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 50.

Kalojmë te neni 51.

Kush është dakord me nenin 51?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 51.

Kalojmë te neni 52, “Institucionet e Arsimit të Lartë”

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Kjo “zbulimet shkencore” më duket fjalë shumë e madhe.

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Edhe mendoj që ta bëjmë “kërkimet shkencore”, sepse edhe poshtë është “veprimtari kërkimore- shkencore”.

Kush është dakord me nenin 52 me këtë ndryshim?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 52.

Kalojmë te neni 53, “Bashkëpunimi ndërkombëtar”.

Elona Gjebrea – Te pika 2 thuhet: “Apeli për asistencë drejtuar organizmave ndërkombëtare të shteteve të tjera, në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësive natyrore bëhet nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme dhe për rastet e tjera bëhet nga ministria”.

Këtu mund të shtohet “me propozim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile, se kështu duket sikur i jep një autoritet punëve të jashtme pa pasur një koordinim.

Ermonela Felaj – Problemi është se ne duhet të bëhemi pjesë e mekanizmit europian për mbrojtjen civile dhe kontaktet i ka Ministria e Punëve të Jashtme.

Urdhëroni, zoti Shehu!

Ismail Shehu – Janë dy situata. E para është kur shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore dhe e dyta është kur nuk shpallet gjendja, pra kemi emergjencë, por nuk është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore. Tek e para hyn Ministria e Punëve të Jashtme dhe përveç saj ngrihen

edhe KNEC-të etj., etj., dhe bashkëveprojmë me këtë ministri për të bërë kërkesën e apelit për ndihmë.

Ndërsa në rastet kur ka fatkeqësi, por nuk është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, pra mund të jetë një shi lokal apo një lëkundje dheu e të tjera, është e tepërt të kërkosim angazhimin e Ministrisë së Jashtme për të kërkuar një asistencë, që normalisht është shumë herë më e vogël se në rastet e fatkeqësisë. Pra, bëhet fjalë për ndodhi apo fatkeqësi të nivelit lokal.

Haki Çako – Marrim shembullin kur në momente të caktuara kemi nevojë për ndërhyrje nga ajri për një helikopter nga Mali i Zi. De facto kemi një mirëkuptim për të ndërhyrë, por nëse do të presim të bëjmë procedurat me Ministrinë e Jashtme kjo do të ishte humbje kohe. Kjo gjë është marrë në konsideratë që mund të operohet edhe drejtpërdrejt, por në përputhje të plotë me kuadrin ligjor.

Elona Gjebrea – Atëherë, duhet theksuar roli i Ministrisë së Jashtme, se këtu futet në lojë kjo ministri, kurse këtu del si indirekt. Si operohet? Pra, duhet theksuar. Unë mendoj që do një rregullim që të kuptohet më mirë.

Ismail Shehu – Ministria e Punëve të Jashtme vihet në lëvizje në bazë të vendimit të marrë nga Komiteti Ndërministror.

Ermonela Felaj – Atëherë, besoj se u sqarua kjo pjesë.

Kush është dakord me nenin 53?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 53.

Kalojmë te neni 54, “Marrja e asistencës”.

Në pikën 4, thuhet: “Autoriteti përgjegjës për koordinimin e mbështetjes së vendit pritës në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore është Komiteti Ndërministror, ndërsa në rastet e tjera AKMS-ja”. Pra, fillon që këtu ndërveprimi.

Kush është dakord me nenin 54?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 54.

Kalojmë te neni 55, “Kalimi i kufirit”.

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Te pika 1, në fund, thuhet: “kryhet me procedura të përshpejtuara dhe të lehtësuara sipas...”. A duhet ta themi këtë?

(Diskuime pa mikrofon)

Dakord.

Ermonela Felaj - Kush është dakord me nenin 55, duke reflektuar këtë shtesën e vogël?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 55.

Kalojmë te neni 56, “Dhënia e asistencës jashtë kufijve të RSH-së”

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Te pika 2 mund ta ndryshojmë këtë “ajo mund të konsistojë edhe në ekspertë”.

Ermonela Felaj – E bëjmë “ajo mund të jetë edhe në ekspertë”.

Unë në fakt e bëra ndërhyrjen që në fillim që ligjin në pikëpamjen gjuhësore ka disa të meta, kështu që do të ishte mirë që, përpara se të vinte teksti i zbardhur në Kuvendin e Shqipërisë, t’i hidhej një sy nga ana gramatikore.

Kush është dakord me nenin 56?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 56.

Vazhdojmë me kreun VIII, “Të drejtat dhe detyrimet e shtetasve” dhe nenin 57.

Kush është dakord me nenin 57?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 57.

Kalojmë te neni 58, “Detyrimet e shtetasve”.

Kush është dakord me nenin 58?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 58.

Kalojmë te neni 59, “Kategoritë e përjashtuara”. Pra, cilat janë kategoritë shoqërore që përjashtohen nga detyrimi për të dhënë ndihmë në rastet e fatkeqësive.

Kush është dakord me nenin 59?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 59.

Kalojmë te neni 60, “Të drejtat e subjekteve private dhe OJF-ve”.

Urdhëroni, zonja Duka!

Valentina Duka – Termi “në mënyrë të përhershme” nuk më shkon, ndoshta duhet të ishte “në mënyrë të vazhdueshme”. Mendoj se sa herë përmendet kjo duhet të zëvendësohet me “në mënyrë të vazhdueshme”.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Ne mund ta zëvendësojmë me një fjalë të vetme dhe le të themi: “subjektet private kanë të drejtë të informohen në mënyrë të vijuar për riskun”.

Te fjala “të vijuar” e ke brenda edhe përditësimin, edhe vazhdimin.

Dakord.

Elona Gjebrea – Më duket e tepërt pika e tretë, që “kanë të drejtë që kryejnë studime”. Çdo organizatë, e cila regjistrohet në gjykatë, padyshim që e ka të drejtën e vet të bëjë studime për mbrojtjen civile, sepse është OJF. Këtë detyrim nuk kemi pse t’ia japim ne shoqërisë civile, se ndërkohë ne kemi një ligj për OJF-të.

Ermonela Felaj – Është e drejtë, nuk është detyrim.

Kush është dakord me nenin 60?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 60.

Kalojmë te neni 61, “Detyrimet e subjekteve private”.

Mund ta themi “kur kanë mbi 20 punëmarrës”.

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë, mund ta bëjmë këtë rregullim në të gjithë përmbajtjen e nenit 60, që duhet të hartohen dhe të përditësohen planet e brendshme, si vijon: “... kur ato përdoren dhe magazinohen, e të tjera me radhë, duhet të sigurojnë me shpenzimet e tyre pajisjet, kur kanë mbi 20 punëmarrës”. Korrigjimi në pikëpamjen gramatikore të bëhet në të gjithë nenin 61 për t’i bërë fjalitë sa më korrekte dhe për të vënë në pah direkt detyrimin dhe rastin kur lind ky detyrim.

Kush është dakord me nenin 61, me ato riformulime që thamë?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 61.

Kalojmë te neni 62, “Arsimimi”.

Detyrimi i Ministrisë së Arsimit që të bashkëpunojë për programet e dhënies së njohurive për mbrojtjen civile deri në nivelin parauniversitar.

Kush është dakord me nenin 62?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 62.

Kalojmë te neni 63, “Kryerja e trajnimeve”.

Elona Gjebrea – Kam një sugjerim. Këtu arsimimi dhe trajnimi dalin veç. Në qoftë se do të vazhdojmë me këtë logjikë, do të kemi shëndetësia dhe trajnimi e plot gjëra të tjera.

Ndoshta ky neni 62 mund të inkorporohet te nenet e mëparshme, ku themi përgjegjësitë që ka ministria përgjegjëse për arsimin.

Ermonela Felaj – Janë dy gjera të ndryshme:

E para ka të bëjë me detyrimin që ka të bëjë Ministria e Arsimit dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile hyn në mënyrë indirekte.

E dyta është rasti kur vetë AKMC-ja i bën trajnimet për gjithë strukturën vartëse të saj.

Kush është dakord me nenin 63?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 63.

Kalojmë te neni 64, “Buxheti i mbrojtjes civile të institucioneve qendrore”.

Kemi një riformulim nga Komisioni i Ligjeve, i cili thotë që pika 1 të riformulohet pasi buxheti i ministrive është pjesë e buxhetit të shtetit dhe nuk është e nevojshme të ndahen më vete.

Pika 1 riformulohet në këtë mënyrë: “Buxheti i mbrojtjes civile i institucioneve qendrore përbëhet nga buxheti vjetor i çdo ministrie, i parashikuar si zë më vete për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile”.

Urdhëroni, zoti Shehu!

Ismail Shehu – Arsyeja pse është vënë te buxheti i shtetit është sepse këtu flasim për buxhetin e mbrojtjes civile në tërësi, pra jo vetëm të ministrive, por ka edhe institucione të tjera varësie, edhe institucione të tjera qendrore, edhe institucione me specifika teknike, që nuk janë detyrimisht pjesë e një ministrie. Duke pasur parasysh këtë menduam se buxheti i shtetit është ai që i detajon.

Ermonela Felaj – Të them të drejtën më duket me vend arsyetimi juaj dhe mirë është që ne të dimë qoftë burimet direkte, qoftë burimet indirekte për të kuptuar se sa shteti e mbështet mbrojtjen civile në total. E thënë në këtë mënyrë, kjo na e mundëson marrjen e kësaj të dhënë.

Do t’ju ftoja që ta votonim siç është!

Valentina Duka – Te pika 2 ju thonë “burime të tjera që i lejon ligji”. Burime të tjera që i lejon ligji janë të parashikuara te donacionet, se ti mundësi të tjera nuk ke. Çfarë mendon se mund të përfshihet këtu?

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Shehu!

Ismail Shehu – Faktikisht, kjo është formuluar ekzaktësisht nga Ministria e Financave, por ka edhe diçka te buxheti vjetor specifik.

Ermonela Felaj – Ka edhe mundësi të gjërat e konfiskuara, të sekuestruara.

Sa miratuam paketën kundër pastrimit të parave. Ti ke një sërë pasurish aty, të luajtshme apo të paluajtshme, të cilat mund t'i vësh në dispozicion të emergjencave.

Kush është dakord me nenin 64?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 64.

Kalojmë te neni 65, “Buxheti i bashkive”.

Ka një vërejtje nga Komisioni i Ligjeve, i cili riformulon pikën 1 dhe pikën 2, po citoj: “Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4% të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit”.

Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si më poshtë vijon: të ardhurat vendore, fondet e të tjera me radhë”.

Në qoftë se ju keni rënë dakord në Komisionin e Ligjeve, e shoh të panevojshme ta diskutojmë më tej.

Kush është dakord me nenin 65?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 65.

Kalojmë te neni 66, “Fondi i solidaritetit”.

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Pse e lini këtë shprehjen “në një bankë”? Mund të thuhet “në banka të nivelit të dytë”.

Ermonela Felaj – Po mund të jetë çfarëdo banke e nivelit të dytë. Nuk kemi ndonjë problem këtu.

Kush është dakord me nenin 66?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 66.

Kalojmë te neni 67, “Inspektimi”.

Doja t’ju kujtoja se për këtë nen, te germa “c”, Komisioni i Ligjeve ka propozuar që kjo germë të hiqet, se planifikimi i fondeve nuk mund të jetë objekt inspektimi.

Planifikimi i fondeve për institucionet vendore dhe qendrore bëhet sipas parashikimeve që ka ligji për buxhetin e shtetit.

Këtu duket sikur ka një përplasje me prefektin, se ne ia kemi lënë prefektit për ta kontrolluar.

Ismail Shehu – Faktikisht, ky ligj është parë në shumë plane. Kontrolle do të ketë që nga Kuvendi, kur bëhet raportimi, te KM-ja, te ministri, te AKMC-ja, te prefekti.

Ermonela Felaj – Ai kontrolli ynë nuk është kontroll në vend, ai është pamje e njëanshme, kurse kontrolli në vend që ballafaqon gjendjen faktike, mendoj se është prefekti.

Na thoni diçka edhe për inspektorët, meqenëse ka një propozim nga ligjet për këtë pjesë. A duhet të qëndrojë sipas jush?

Haki Çako – Për ne duhet të qëndrojë, sepse kjo nuk është vetëm për bashkitë. Ata e personalizojnë për bashkitë, por janë të gjitha institucionet që duhet të planifikojnë buxhet, e para.

E dyta, ne nuk jemi në gjendje të dalim në një konkluzion për përdorimin e një buxhetimin të përcaktuar për mbrojtjen civile, nëse nuk inspektojmë, nuk kontrollojmë në mënyrë specifike, sepse në mënyrë zyrtare ose verbalisht ne mund të marrim informacione sa të duam, por nëse nuk është e përcaktuar në ligj mënyra se si do të duhet të inspektohet aplikimi i këtij buxheti në mënyrë specifike, kur qeveria e akordon si buxhet të specifikuar, nuk ka si të bëhet.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

A ka koment tjetër nga kolegët?

Pra, jemi dakord me argumentimin e zotit Çako.

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Folëm më parë për krijimin e një databaze dhe më duket se bëhen shumë. Jam pak konfuze te kjo pjesë. Pra, inspektorët janë përgjegjës për të krijuar një bazë të dhënash të humbjeve nga fatkeqësitë.

Këtë gjë sikur e diskutuam më lart, që ishte një strukturë tjetër për këtë.

Ismail Shehu – Nuk diskutohet për inspektorët, por për procesin e inspektimit.

Ermonela Felaj – Dakord.

Ne nuk e pranuar sugjerimin e Komisionit të Ligjeve dhe do të mbështesim ministrinë propozuese.

Kush është dakord me nenin 67?

Faleminderit! Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 67.

Kalojmë te neni 68, “Kundërvajtjet administrative”.

Ka një koment nga Komisioni i Ligjeve, ku thuhet: “Në këtë nen, togfjalëshi “shkelja e njëjës prej dispozitave të parashikuara në shkronja”, të zëvendësohet me “shkelja e kërkesave të parashikuara në shkronja”.

Gjithashtu, rekomandohet që masa e gjobës të përcaktohet me interval, pasi kemi të bëjmë me disa lloje shkeljesh.

Mund të themi me “diapazon” ose me “marzh”, por jo me “interval”.

Të themi të drejtën shkronjat parashikojnë dispozitat, parashikojnë norma dhe jo kërkesa, kështu që shprehja e ministrisë më duket korrekte.

Për sa i takon gjobës jam dakord që të mos përdoren gjobat fikse, sepse përgjithësisht edhe nga Gjykata Kushtetuese, në situata të tjera, është quajtur si shkelje përdorimi i dënimeve fikse, sepse çdo shkelje ka rëndësinë apo pasojën e vet të matshme, kështu që do të ishte mirë të përdorni një marzh dënimi me një minimale dhe me një maksimale, që mund të jetë në këto nivele. Nuk jam duke e penalizuar, por duke pasur parasysh se e keni penalizuar në nivelin e ulët, rritja deri në 200 mijë mund të japë një masë vlerësimi nga ana juaj.

(Diskutime pa mikrofon)

Ne mund ta bëjmë 50 me 100 dhe merr kuptim edhe marzhi, që të mos e bëjmë qëllim më vete vendosjen e gjobave, se ne duam që njerëzit të korrigjohen dhe jo të ndëshkohen në masën që nuk vetëkorrigjohen dot më.

Për një kundërvajtje normale 500 mijë lekë të vjetra gjobë nuk është pak, se po flasim për kundërvajtje administrative dhe për nivelin e masave.

Atëherë, e lëmë 50-100 mijë, se ju nuk keni dashur të dilni mbi 100 mijë. Ne po vëmë thjesht marzhin.

Dakord.

Kush është dakord me nenin 68, me reflektimin që u bë për pikën 1?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 68.

(Diskutime pa mikrofon)

Kalojmë te neni 69.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk i ngelet gjë për të vlerësuar ministrin këtu. Do të thosha se drejtori duhet ta marrë këtë kompetencë, se ai ka të bëjë me inspektorët.

Atëherë, bëjmë këtë ndryshimin që formati i procesverbalit miratohet me urdhër të drejtorit.

Në fakt, te kompetencat e drejtorit, ju e keni “nxjerr akte administrative në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative”. E keni të përshkruar te detyrat që ka neni 24. Edhe procesverbali akt administrativ është.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë do të isha dakord të jetë “me urdhër të drejtorit”.

Kush është dakord me nenin 69?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 69.

Kalojmë te neni 70.

Këtu ka një ankim të drejtë për t’u ankuar kundër gjobës. Ankimi ezauron rrugën administrative, pra shkon te agjencia pastaj shkon në gjykatë. Edhe afatet duken të drejta.

Kush është dakord me nenin 70?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 70.

Kalojmë te neni 71.

Kush është dakord me nenin 71?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 71.

Kalojmë te neni 72.

Unë po ju citoj afatin që keni propozuar dhe të shohim se cilin prej tyre mundemi ta zvogëlojmë.

Për vlerësimin e riskut, që është detyrim që bëhet në nivel qendror, në nivel qarku, në nivel vendor jo më pak se një herë në tri vjet keni propozuar afatin dyvjeçar.

Për strategjinë kombëtare për zvogëlimin e riskut, për vërtetimin e riskut që u jepet subjekteve ndërtimore, për planet për emergjencat civile, për Komitetin e Mbrojtjes Civile dhe zyrën përgjegjëse për situatën, për ministritë dhe institucionet qendrore, për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile... Lista qenka shumë e gjatë.

Më mirë po i marrim një për një.

“Për vlerësimin e riskut” jemi dakord ta lëmë 2 vjet apo ta bëjmë 1 vit?

Pra, vlerësimi i riskut në nivel qendror miratohet me VKM me propozim të ministrit, ndërkohë që bëhet një herë në çdo 3 vjet. Ne thamë se po të lëmë 2 vjet, ato do të mbarojnë mandatet dhe s’do t’i përfundojnë asnjëherë. Kështu që thamë të lëmë 1 vit.

(Diskutime pa mikrofon)

Dakord. Kjo do të lihet 2 vjet.

“Strategjia kombëtare për zvogëlimin e riskut”. Normalisht, përderisa është strategji, e lëmë ashtu siç është, 2 vjet.

“Vërtetimi i riskut” thamë se duhet ta shkurtojmë. 6 muaj.

“Planet për emergjencat civile” sa do t’i lëmë? Besoj se do t’i lëmë 2 vjet se ju i keni bërë të tilla planet që duhet të rakordojnë me planin kombëtar.

Po e lëmë kështu siç është, 2 vjet.

“Organizimi dhe funksionimi i Komitetit të Mbrojtjes Civile”. Këtë do ta lëmë të ndodhë për 2 vjet? Dakord e lëmë 1 vit.

“Ministritë dhe institucionet qendrore”. Pra, 22-shi ngelet siç është.

Vazhdojmë me 23-shin, “Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile”.

Edhe 23, pika 7, “Organizimi dhe funksionimi i AKMC-së” e lamë 6 muaj.

“Komisioni Teknik Këshillimor” e lëmë 1 vit.

Vazhdojmë me nenin 26, “Qendrat e mbrojtjes civile në qark”. 1 vit.

Neni 38, “Shërbimi i vullnetarëve për mbrojtjen civile”. E lëmë siç është.

Neni 40, “Kategorizimi i emergjencave civile”.

(Diskutime pa mikrofon)

2 vjet. Dakord.

Neni 41, “E drejta e kompensimit”. Ne e lamë 1 vit, te pika 6.

Neni 47, “Numri i unifikuar i thirrjeve urgjente”.

Zoti Çako, si mendoni ju, sa kohë u desh kur u ngrit numri i unifikuar i policisë?

Haki Çako – Është një investim shumë i rëndësishëm, në fakt. Në qoftë se do të ngrihet në shkallë kombëtare, kërkon buxhet të fuqishëm dhe nëse do të duhet të funksionojë në një sistem të vetëm në shkallë vendi, do të duhet patjetër një periudhë dyvjeçare, të paktën.

Ermonela Felaj – Dakord. E lëmë 2 vjet.

“Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga fatkeqësitë”. E lëmë siç është.

Neni 50, “Llojet e sinjaleve të alarmit, numri dhe mënyra e përdorimit të tyre”.

Haki Çako – Të gjitha janë të lidhura me buxhetim dhe, mbi të gjitha, edhe me projekte të caktuara.

Ermonela Felaj – Atëherë, do të lëmë siç është, 2 vjet.

Besoj se neni 51 ka të njëjtin arsyetim.

“Procedurat dhe kriteret e ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile miratohet më VKM dhe për këtë ngarkohet Kryeministri që brenda 1 viti të nxjerrë aktin nënligjor”.

Jemi dakord për 1 vit. Dakord.

Pika 2, neni 72, fjalën “Kryeministri” do ta bëjmë “KM”, se Kryeministri është institucion kushtetues dhe detyrimet i ka nga Kushtetuta. Se kështu e ngarkojmë në mënyrë të

skajshme dhe e bëjmë përgjegjës përball një gjëje që nuk është themelore për veprimtarinë e Kryeministrit.

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë, meqenëse pjesën më të rëndësishme ne e diskutuam, do t'ju ftoja që në përmbajtjen e nenit 72 të saktësojmë cilat janë nenet dhe cilat janë pikat, se kështu siç shkruar bëhet pak rrëmujë.

Deri këtu po vendosim këto afate. Besoj se këshilltarët e komisionit i kanë shënuar, kështu që në zbardhje, për ndonjë korrigjim të vogël (kuptohet që nuk është i natyrës formale), do të merrem vesh me drejtorin.

Kush është dakord me nenin 72?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 72 me ndryshimet që thamë.

Kalojmë te neni 73, “Dispozita kalimtare”.

Urdhëroni!

Elona Gjebrea – Kjo fjala “transformohet” nuk më pëlqen, mund të bëhet “kthehet” apo “shndërrohet”.

Ermonela Felaj – Dakord.

Kush është dakord me neni 73, me vërejtjen e zonjës Gjebrea?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 73.

Kalojmë te neni 74, ligji “Për emergjencat civile” i ndryshuar” shfuqizohet.

Kush është dakord me nenin 74?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 74.

Kalojmë te neni 75, tek i cili do të bëja vetëm një ndërhyrje të vogël, kjo “i shtrin efektet” të zëvendësohet me “i fillon efektet”, apo “i shtrin efektet duke filluar nga data 1.1.2020”

Urdhëroni, zoti Çako!

Haki Çako – Dakord jemi.

Së pari, falënderoj komisionin! Ju falënderoj të gjithëve për përkushtimin!

Ermonela Felaj – Kolegë, ju falënderoj të gjithëve! Falënderoj edhe kolegët që vijnë nga Ministria e Brendshme për interesin që treguan për të marrë pjesë!

Sigurisht, ligji, duke qenë i ri, ka vështirësitë e veta për të gjitha nocionet e reja që sjell, por unë besoj se koha e gjatë e diskutimeve që bëme na ka shërbyer për të bërë ndërhyrjet e duhura.

I ftoj kolegët ta miratojmë në tërësi këtë projektligj!

Kush është dakord me projektligjin “Për mbrojtjen civile” në tërësi?

Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me unanimitet.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA